





Kanton Zug

Sistemi i arsimit në Kantonin e Cug-ut

Takim informativ në gjuhën shqipe

Andrea Lier, udhëheqëse i inspektoratit të shkollave, Enti për shkollat e komunës

1. Bazat e sistemit shkollor
2. Gjermanishtja si gjuhë e dytë
3. Vlerësimi
4. Kopshtet e fëmijëve, shkolla fillore, shkolla sekundare, shkalla I
5. Kalimi nga shkolla fillore – shkolla sekundare, shkalla I
6. Kalimi nga shkalla Sek. I. – në shkollat e mesme dhe shkollat me provim mature
7. Oferta plotësuese




Në këtë prezentim do te trajtohen këto tema:

- Strukturat themelore si dhe mundësitë e shumta që ofron sistemi, por gjithashtu edhe bashkëpunimi me prindërit.
- Si trajtohen në Kantonin e Cug-ut fëmijët, të cilët nuk e njohin aspak, ose shumë pak gjermanishten. Këtu flasim për gjermanishten si gjuhë e dytë. (DaZ)
- Prej kur fillon dhe si vlersohet suksesi i fëmijëve?
- Ne grafiken e sistemit shkollor të Cug-ut sqarohen shkallët dhe karakteristikat e shkollimit: mesimi parashkollor, shkolla fillore, shkolla sekundare, shkalla I
- Kalimit nga njëra shkallë në tjetrën i kushtojmë kujdes të vecantë. Si bëhet konkretisht kalimi prej në shkollën fillore në kl. e I Sek. dhe prej shkollës sekundare në shkollën e mesme.
- Shumë komuna kanë edhe oferta plotësuese. Çfarë përfshijnë keto oferta?

1. Bazat e sistemit shkollor në përgjithësi


- Lehrplan 21 Kanton Zug (<https://zg.lehrplan.ch>)
- Klasat e rregulta, klasat e vogla
- Integrimi i fëmijëve që kanë vështirësi në mësim
- Mbështetja nga ana e pedagogëve të specializuar
- Në parim nxënësit nuk e përsërisin klasën.



Kanton Zug		Zug	Downloadbereich
Startseite	1. Zyklus KG / 1.-2. Klasse Primarstufe	2. Zyklus 3.-4. Klasse Primarstufe	3. Zyklus 1.-3. Klasse Sekundarstufe I
Überblick	Deutsch als Zweitsprache (nicht verbindlich)		

Bazat e sistemit shkollor në përgjithësi

- Plani i ri mësimor Lehrplan 21 Kanton Zug (nga viti shkollor 2019/20)
- Në parim klasat e rregullta dallohen nga klasat e vogla.
- Nxënësit e klasave të rregullta arrijnë ta përvetsojnë programin mësimor.
- Në klasat e vogla programi mësimor u përshtatet nxënësve. Secili fëmijë ka një program individual. Kjo klasë përbëhet me fëmijë që kanë vështirësi në mësim.
- Mëgjithatë në shumicën e shkollave fëmijët me vështirësi në mësim integrohen në klasat e rregullta.
- Ata kanë orë mësimi me pedagogët e specializuar dhe punojnë pjesërisht me programin e tyre individual.
- Në parim nxënësit nuk e përsërisin klasën.
- Në raste të veçanta rektori e lejon përsëritjen e klasës. Vendimin e sjell ai.



Mundësitë e Sistemi arsimor në Kantonin e Cugut

- „Shumë rrugë të çojnë në Romë“
- Sistemi i arsimit në Cug karakterizohet me mundësitë jashtëzakonisht të larta për nga shumëllojshmëria e ofertave. Aty ka mundësi për zhvillimin e fëmijëve dhe rinisë në aspekte të ndryshme .
- Degëzimi i rrugëve në mbarim të shkollës fillore (shkalla e parë), mundëson zgjedhjen e një drejtimi, por jo edhe të vetmin dhe të fundit. Qëllimet mund të arrihen përmes rrugëve të shumta. Kjo çdo herë mundëson zgjedhjen e një drejtimi tjetër të dëshiruar.
- Ndonjëherë qëllimet nuk mund të arrihen përmes një rruge direkte. Rrugët tjera janë të tërthorta, por ndonjëherë janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës. Rruga e drejtëpërdrejtë nuk është gjithmonë më ideale për secilin fëmijë. Një synim megjithatë mund të arrihet. Gjatë shkollimit të obligueshëm janë të hapura shumë rrugë.

1. Bazat e sistemit shkollor në përgjithësi



Burimi: www.sehtestbilder.de
(Gjendja: 6. September 2013)


Präsentation der Übertrittskommission I

6

Disa flalë sqaruese

- Kush sheh një grua plakë në këtë fotografi? Kush sheh një grua të re? Kush i sheh të dyja?
- Ashtu si në këtë fotografi, në shkollë edhe në shtëpi ka këndvështrime të ndryshme apo pikëpamje të ndryshme. Prindërit apo tutorët e vlerësojnë fëmijën e tyre nga perspektiva e përvojës së tyre personale me fëmijën në kohën e lirë, e cila përfshin shtëpinë, rrethin familjar, rrethin e miqëve ose fqinjët. Mësuesi e vlerëson fëmijën nga perspektiva e ambientit shkollor duke e drejtuar shikimin kah mësimi në tërësi. Të dyja perspektivat janë të rëndësishme dhe domethënëse. Optimale është kur të dyja perspektivat merren parasysh, përkatësisht kur ato plotësohen mes veti, vërtetohen, pasurohen dhe kështu sjellin deri tek vlerësimi i përbashkët i gjendjes. Në raste të pikëpamjeve të ndryshme, nëse secila palë e mbron vetëm mendimin e vet sie të drejtë, zvogëlohet mundësia për arrijtjen e qëllimit.

1. Parimi themelor - Bashkëpunimi



Bashkarisht



Präsentation der Übertrittscommission I

7

Parimi themelor - Bashkëpunimi

- Në të gjitha kërkesat e shkollës është i dobishëm dhe fitimprurës bashkëpunimi i prindërve me shkollën, që do të thotë kryesisht bashkëpunim me mësuesin. Në raste keqkuptimesh dhe paqartësish ju këshillohet që ta kontaktoni mësuesin. Më së miri është ta njohtoni me shkrim nëse ka ndodhur diçka me rëndësi që ka të bëjë me shkollën. Të gjithë duhet të angazhohen për një bashkëpunim të mirëfilltë. Si prindërit, ashtu edhe mësuesit e kanë për qëllim ta mësojnë fëmijën dhe t'i krijojnë mundësi të arrijë suksese në shkollë. Ndonjëherë ka mospajtime, mirëpo ia vlen t'u besoni mësuesëve, sepse ata kanë përvojë dhe i dinë mundësitë. Ndonjëherë, një „rrugë e tërthortë „ premtan rezultate më të mira dhe mundësi më të madhe për arritjen e synimeve.
- Ky tregim i shkurtër na tregon së pari se si nuk duhet të veprohet. Nëse prindërit dhe mësuesit shkojnë në drejtime të kundërta, vjen deri te tensioni. Në këtë situatë vuan fëmija, i cili në të vërtetë ka dëshirë t'i kënaq të dyja palët. Kur prindërit dhe mësuesit shkojnë në të njëjtin drejtim, të dyja palët ia arrijnë qëllimit.
- Bashkëpunimi i prindërve me shkollën, për fëmijët është elementi kryesor i sistemit tonë shkollor.
- Shkolla i ka përgjegjësitë e veta. Prindërit gjithashtu i kanë përgjegjësitë e veta dhe janë pjesë e sistemit shkollor.
- Qëllimi ynë është që së bashku ta gjejmë rrugën mbi të cilën të ecim bashkarisht.

2. Gjermanishtja si gjuhë e dytë

- DaZ-Mësim për fëmijët që e dinë pak ose që se dinë aspak gjermanishten
- Mësimi për fillestarët - pjesërisht në klasa të ndara- 8 deri 10 orë në javë
- Mësimi për përforcimin e gjuhës, më së paku 2 orë në javë-DaZ



Gjermanishtja si gjuhë e dytë

▪ Fëmijët me gjuhë të huaj amtare, që kanë njohuri të pamjaftueshme ose që nuk e flasin gjermanishten fare, mvarësisht prej moshës, ndjekin 8 deri 10 orë mësimi plotësues për fillestarë në javë. (DaZ). Fëmijët që në të vërtetë kuptojnë, por që ende kanë vështirësi të mëdha me gjermanishten, për përforcimin e saj ndjekin më së paku 2 orë mësimi plotësues në javë. (DaZ). Mësimi për fillestarët mund të mbahet edhe në klasa të ndara me qëllim që sa më shpejt të mund të inkuadrohen në klasën e rregullt.

3. Vlerësimi

Vlerësimi dhe nxitja V&N (B & F)


- Njohuritë në mësim, aftësitë për të mësuar, përgjegjshmëria ose kompetenca individuale dhe ajo sociale
- Vlerësimi i tërësishëm → Masat për nxitje - *Dëftesa e notave*
- Prej kl. së 2. gjithmonë në fund të semestrit (31. Janar dhe në fillim të korrikut)



Vlerësimi

- Shkollat e Cug-ut e bëjnë vlerësimin sipas parimit vlerëso dhe nxit. V&N (B&F)
- Gjatë vlerësimit nuk mirren parasysh vetëm rezultatet në lëmitë mësimore, por edhe kompetencat jashtë mësimin, siç janë ato shoqërore dhe individuale. Në bazë të vlerësimit merren masa nxitëse për përparimin e mëtutjeshëm të fëmijëve të veçantë.
- Çdo vit mbahet një bisedë orientuese me prindin dhe fëmijën në çdo klasë, prej kopshtit deri në mbarimin e shkollës sekundare, shkalla I
- Prej klasës 2. fillore, në fund të çdo semestri të vitit shkollor u jepet fëmijëve dëftesa e notave.

4.1. Foshnjerja, shkolla fillore, shkolla sekundare



Foshnjerja

■ Të gjitha komunat e Cug-ut ofrojnë foshnjore dy vjeçare. Mësuesit obligohen të punojnë sipas një plan-programi të përbashkët mësimit. Ndjekja e vitit të parë të foshnjores nuk është e detyrueshme, ndërsa viti i dytë është i detyrueshëm. Ky vit i detyrueshëm i foshnjores merret si regjistrim apo hyrje në shkollë.

Kufizimi i moshës për regjistrim në shkollë:

Arsimi i detyrueshëm: regjistrimi i detyrueshëm në shkollë: Nëse fëmija deri më 28 apo 29 shkurt i mbush 5 vjet, në vitin vijues detyrohet që ta ndjekë mësimin në foshnjore.

E drejta shkollore: Regjistrim vullnetar: Nëse fëmija deri më 31 maj i mbush 5 vjet, në vitin vijues i lejohet regjistrimi në foshnjoren e detyrueshme.

Regjistrimin e më hershëm ose atë të më vonshëm mund ta lejojë rektori.


Shkolla fillore

■ Shkolla fillore zgjat 6 vjet.

■ Shkalla e ulët: kl. 1 dhe kl. 2; Shkalla e mesme I: kl. e 3. dhe 4; Shkalla e mesme II: kl. 5. dhe 6.

■ Pasi shumë shkolla në Cug praktikojnë mësimin integrativ, kanë mbetur edhe pak klasa të vogla.

■ Për këtë shkak edhe nxënësit me vështirësi, në të shumtën e rasteve e ndjekin mësimin në klasat e rregullta.




Shkolla sekondare shkalla I

- **Klasa për përgatitje për zanate:** 3 vjet - kjo është klasë e vogël në shkallën I të shkollës sekondare që kërkon përkrahje të veçanta dhe ka për qëllim thellimin dhe zgjerimin e mësimit fillor dhe nxitjen e mësimit praktik.
- **Shkolla real:** 3 vjet - ...thellon përmbatjet mësimore të shkollës fillore dhe i zgjeron ato duke vënë në plan të parë përvojën e nxënësve. Gjatë përpunimit të përmbajtjeve mësimore, gjithmonë iu referohemi situatave nga jeta e përditshme. Ajo i përgatit nxënësit për shkollën e profesioneve zejtare.
- **Shkolla sekondare:** 3 vjet -i përgatit nxënësit për regjistrim në shkollat e mesme dhe ato profesionale. Aty kërkohet mendjemprehtësi, aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur si dhe të kuptuarit e mësimeve abstrakte.
- **Gjimnazi i ulët (fazë e gjimnazit të plotë):** 2 vjet - ...Gjimnazi i ulët i përfshinë dy vitet e para të gjimnazit gjashtëvjeçar (Gjimnazi i plotë). Mbi bazën e një mësimi të përgjithshëm, gjimnazi i ulët i krijon kushtet për shkollim me maturë. Gjimnazi është paraparë për nxënësit, të cilët me talentin dhe aftësitë e tyre qëndrojnë mbi mesataren e asaj që kërkohet. Si pikë orientimi për hyrjen në gjimnazin afat-gjatë vlen nota 5.2. E njëjta vlerë orientimi mendohet që do të vlejë edhe për hyrjen në Gjimnazin e lartë. Përveç kësaj është e domosdoshme që të kenë një synim të qartë për ta përfunduar maturën. Gjimnazi i ulët nuk i përgatit nxënësit për profesione zejtare.

4.2. Klasat kooperative të shkallës së lartë


- Shkolla real dhe sekundar
- Kurse gjithëpërfshirëse për nxënës të të dy niveleve
- Lëndët e niveleve: Matematika dhe anglishtja, opcion – gjermanishtja dhe/ ose frëngjishtja
- Ndërrimi i nivelit bëhet në fillim të një semestri, me përjashtime edhe gjatë semestrit



Klasat kooperative


- Shkolla sekondare dhe ajo real punojnë si klasa kooperative të shkallës së lartë.
- Në lëndë të caktuara mbahen kurse gjithëpërfshirëse për nxënësit e të dyja niveleve, në të cilët nuk kërkohen rezultate të njëjta nga të gjithë nxënësit .
- Kjo u mundëson nxënësve të klasës real që në lëndët e nivelit t'i nxjerrin në pah pikat e tyre të forta, ndërsa atyre të klasës sekondare u mundëson që pikat e tyre të dobëta t'i plotësojnë me njohuri të reja.
- Lëndët e niveleve janë matematika dhe anglishtja. Komunitat vendosin vet a dëshirojnë të jenë aty edhe gjermanishtja dhe/ose frëngjishtja.
- Për klasifikim në lëndët e nivelit mirret parasysh nota përkatëse e nxënësit në dëftesën e semestrit të dytë të kl. së 6. Prej notës 4.5 e lartë, nxënësi klasifikohet në nivelin A, prej 4 e më poshtë, në nivelin B.
- Nga njëri nivel në tjetrin mund të kalohet vetëm në fillim të semestrit. Për këtë mirret parasysh sukcesi dhe zhvillimi i nxënësit. Përjashtim bën vetëm nëse kolegji i mësuesëve e rekomandon këtë.

4.2. Klasat kooperative të shkallës së lartë



* Die Gemeinden können entscheiden, ob sie zusätzlich Deutsch und/oder Französisch als Niveaufach führen wollen.

4.3. Klasat kooperative – kalimi prej real në sek. dhe e kundërta



- **Kalimi prej real → në Sek:** me më shumë nota të mira në M, GJ, F, Ang., H&Gj (RZG), Bio., Ki., Fiz.(NT), si dhe me njohuri dhe aftësi për të mësuar e me kompetenca sociale dhe individuale
- **Kalimi prej në Sek → në real:** me më shumë nota të pamjaftueshme në M, GJ, F, Ang., H&Gj, (RZG), Bio., Ki., Fiz. (NT); me njohuri dhe aftësi të pakta për të mësuar, me kompetenca të mangëta sociale dhe individuale

Präsentation der Übertrittskommission I

14

Klasat kooperative

- Ndërrimi i klasës zakonisht bëhet në fillim të vitit shkollor. Në raste të veçanta, kur vërehet se nxënësi është i ngarkuar shumë, respektivisht pak, mundet ta ndërrojë klasën edhe gjatë vitit shkollor.
- Nëse një nxënës i klasës real kalon në kl. sekundar, ai qysh para kalimit do të ndjekë një kurs të posaçëm përgaditor, kështu që integrimi në kl. sekundar të jetë i suksesshëm.
- Nxënësit e kl. real që tregojnë rezultate të mira në lëndët: Matematikë, gjermanisht, frëngjisht, anglisht, shkencat natyrore, që tregojnë aftësi për të mësuar dhe që kanë kompetenca sociale dhe individuale mund të kalojnë në kl. sekundare.
- Nxënësit e kl. sekundare që nuk tregojnë rezultate të mira në lëndët: Matematikë, frëngjisht, anglisht, shkencat natyrore, që nuk tregojnë aftësi për të mësuar dhe që nuk kanë kompetenca sociale dhe individuale dërgohen në kl. real.

5. Kalimi nga shkolla fillore- në shkollën sekundare, shkalla I

Mbledhje prindore në Klasen e 5. me këto tema:

- Procedura
- Kriteriumet e vlerësimit
- Bisedë mbi kalimin
- Llojet e shkollës sekundare, shkalla I
- E drejta për ankesa
- Përsëritja e kl. 6.



Prindërit marrin një broshurë informative dhe një fletushkë për kalimin në shkollën tjetër (www.zg.ch/uebertritte).


Procedura I e kalimit

Mbi procedurën e kalimit, prindërit informohen shumë mirë. Në komunë deri në vjeshtë, në kl. e 5. mbahet një takim, ku prindërit njohtohen me procedurën e kalimit. Në këtë takim prindërit njohtohen hollësisht mbi:

- rrjedhën e procedurës
- kriteriumet e vlerësimit
- bisedën mbi kalimin
- kërkesat dhe kushtet për llojin e shkollës sekundare.
- të drejtën për ankesa
- përsëritjen e kl. 6.
- detyrat standarde

Prindërit marrin një broshurë informative dhe një fletushkë për kalimin në shkollën tjetër.

5. Kalimi nga shkolla fillore- në shkollën sekundare, shkalla I




Procedura I e kalimit

- Kalimi nga shkolla fillore- në shkollën sekundare, shkalla I bëhet pa provim. Për llojin e shkollës, në një bisedë këshilluese në kl. 6. vendosin prindërit, mësuesi dhe fëmija së bashku. Gjatë vlerësimit nuk mirren parasysh vetëm rezultatet në lëndët mësimore, por edhe kompetencat jashtë mësimit, siç janë ato shoqërore dhe individuale.
- Vendimi mirret në bazë të suksesit të përgjithshëm dhe zhvillimit të nxënësve. Gjatë kësaj, njohuritë në lëndët mësimore dhe kompetencat shoqërore dhe individuale janë në qendër të vëmendjes.
- Nëse prindërit dhe mësuesi nuk janë të një mendimi vendos komisioni. Vendimi i komisionit për kalim I bazohet në një test sqarues si dhe në shqyrtimin e dosjes së derimëtashëm.

6. Procedura II e kalimit

Shkolla sekundare - Shkollat e mesme kantonale, MP (BM)



Präsentation der Übertrittskommission I

Procedura II e kalimit

Gjimnazi i ulët

- Mundësia e vetme për të kaluar prej shkollës sekundare në gjimnazin e ulët ekziston vetëm në kl. 1. sek., edhe atë vetëm atëherë kur deri nga mesi i nëntorit konstatohet se nxënësi i plotëson kushtet për këtë. Në këtë rast zbatohet mundësia e I e kalimit.

Nga kl. 2. dhe 3. sek. ka mundësi të ndryshme për të kaluar në shkollat e mesme dhe në shkollat për mësimin e profesionit me provim mature.

Shkollat e mesme kantonale, MP (BM)

- Në shkolla kantonale përfshihen: Gjimnazi i lartë në Menzingen (Gjimnazi kantonal Menzingen), Shkollat e mesme profesionale dhe shkolla ekonomike.
- Në këtë rast zbatohet procedura e II e kalimit.

Kalimi pas kl. 2. Sek.

- Në mbarim të kl. 2. Sek. nxënësit mund të kalojnë në gjimnaz të lartë. Në mbarim të gjimnazit të lartë, nxënësit i nënshtrohen provimit të maturës.

Kalimi pas kl. 3. Sek.

- Pas mbarimit të kl. 3. Sek. Nxënësit mund të kalojnë në gjimnazin e lartë.
- Ekziston edhe mundësia e kalimit në shkollat e mesme profesionale (FMS) dhe në shkollën ekonomike.
- Duke u mbështetur në Procedurën II të kalimit, parashihet edhe kalimi në shkollat për mësimin e profesionit me provim mature.
- Pranimi bëhet me lidhjen e një kontrate.

7. Ofertat plotësuese

- Tryezën-sofrën e drekës
- Ndhimë gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë
- Përkujdesje në kohën e lirë
- Aktivitete sportive



Ofertat plotësuese

- Çdo shkollë komunale ka oferta plotësuese: tryezën-sofrën e drekës, ndihmë për kryerjen e detyrave të shtëpisë si dhe përkujdesje në kohën e lirë gjatë qëndrimit në shkollë.
- Përveç kësaj Komuna ofron kurse të ndryshme sportive. Në këto kurse mund të regjistrohet çdo fëmijë .
- Qyteti i Cug-ut ka edhe një shkolle ditore.
- Kjo ofertë bëhet me vendim të Komunës.

Pyetje



Ju falemnderit për vëmendjen

